

## KONTRATË SHIT-BLERJE

Më datë 15/12/2023, nga dhe ndërmjet palëve, lidhet kontrata e mëposhtme:

- SHITËSI:** Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L42223008U, me seli në adresën: Tiranë, Rruga "Brigada 8", Pallati "Lid", Kati 7, Ap.Nr.21 dhe Nr.22, përfaqësuar nga aksionari i vetëm i shoqërisë "Anio Oil&Gas"sha, Z.Alban Peza, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.037062716, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (*në vijim referuar si "Shitësi"*);
- BLERËSI:** Ela Puka, e bija e Konstandin-it, lindur më 19.09.1982, në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr. 038203046, madhore e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me adresë: Tiranë, (*në vijim referuar si "Blerësi"*).

### Kushte të përgjithshme

- A. Shoqëria "Apsus"shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kuñzuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M21730029U dhe me seli në adresën: Tiranë, Rruga "Brigada 8", Ndërtesa Nr.4, Kati 7, Ap.Nr.21&Nr.22, (*më tej referuar si "Shoqëria"*). Kjo shoqëri përbëhet nga tre ortakë, të cilët janë pjesëmarrës në kapitalin e kësaj shoqërie si më poshtë:
1. Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, zotëruese e një kuote të barabartë me 60% (gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 60,000(tetëdhjetëmijë) Lekë.
  2. Z.Alban Peza, zotërues i një kuotë të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.
  3. Z.Andon Daka, zotërues i një kuotë të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
- B. Shitësi deklaron se zotëron 1(një) kuotë të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, e barasvlefshme me 60%(gjashtëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, me vlerë 60,000(gjashtëdhjetëmijë)Lekë.
- C. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit, dhe Blerësi dëshiron të përditëse 20% të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "Apsus"shpk.
- D. Bleresi ka kryer *due diligence* dhe është njojur me secilin nga ortakët e shoqërisë "Apsus"shpk, me çdo të dhënë dhe tregues të aktivitetit tregtar të shoqërisë, të gjendjes ekonomike, financiare dhe juridike të saj, të të drejtave dhe detyrimeve civile, administrative dhe tatimore, aktiveve dhe pasiveve të shoqërise deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- E. Bleresi deklaron se është në dijeni të plotë të Kontratave dhe Marrëveshjeve që shoqëria "Apsus"shpk, ka nënshkruar deri në datën e lidhjes të kësaj kontrate si dhe gjithë

detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga këto kontrata, marrëveshje apo aktiviteti i shoqërisë.

- F. Blerësi deklaron se i pranon dhe nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me sa më sipër, dhe se nuk ka e nuk do të ngrejë asnjë pretendim ndaj tyre, sot dhe në të ardhmen për asnjë arsyе.
- G. Përfundimisht, pas nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes, shoqëria "Apsus"shpk do të përbëhet nga katër ortakë, secili me nga një kuotë, si më poshtë vijon:
1. Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 40%(dyzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 40,000(dyzetëmijë) Lekë;
  2. Z.Alban Peza do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
  3. Z.Andon Daka, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
  4. Znj.Ela Puka do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Apsus"shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.
- H. Në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë "Apsus"shpk, nenin 73 "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", pika 1, shkronja "b", të ligjit nr.9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenin 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë Shitblerje (në vijim referuar si "Kontrata"), me kushtet si më poshtë vijon:

#### **NENI 1 Objekti**

1.1 Me anë të kësaj kontrate, Shitësi i kalon Blerësit titullin e pronësisë të 20%(njëzetë përqind) të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "Apsus"shpk. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me kapitalin në fjalë ndjekin kapitalin dhe kalcjnë gjithashtu në pronësi të Blerësit.

#### **NENI 2 Çmimi dhe Pagesa**

- 2.1 Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit për shitjen e 20% të kapitalit të shoqërisë është 20,000(njëzetëmijë) Lekë. Ky çmim do të paguhet nga Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.
- 2.2 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitësit nëpërmjet transfertës bankare në një nga llogaritë bankare të këtij të fundit.

### **NENI 3 Kalimi i titullit të pronësisë**

3.1 Titulli i pronësisë së 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi kalon në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitblerje.

### **NENI 4 Efektet e shitjes**

4.1 Palët bien dakord se pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe kalimit të titullit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësi, Shoqëria do të ketë këtë strukturë ortakësh:

- I. Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha do të jetë pronare e një (1) kuote të barabartë me 40%(dyzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 40,000(dyzetëmijë) Lekë;
- II. Z.Alban Peza do të jetë pronar i një (1) kuote të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
- III. Z.Andon Daka do të jetë pronar i një (1) kuote të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
- IV. Znj.Ela Puka do të jetë pronare e një (1) kuote të barabartë me 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.

### **NENI 5 Garancitë e Palëve**

5.1 Shitësi garanton Blerësin se:

5.1.1.Pjesët e kapitalit që ai zotëron në shoqëri dhe që janë objekt i shitblerjes sipas kësaj kontrate nuk janë subjekt barresimi, ndalimi shitje, të drejtë parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve.


5.1.2.Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e pjesëve që ai zotëron në kapital dhe që janë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apc miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik.

5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

5.2.1.Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e 20% të kapitalit të Shoqërisë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj.

### **NENI 6 Konfidencialiteti**

6.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negocim parakontraktor do të trajtohet në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apc ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.



6.2 Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit: në rast se:

- Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;
- Transmetimi bëhet në kuadër të përbushjes së një detyrimi;
- Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik;
- Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
- Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njoitura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

### **NENI 7 Komunikimi ndërmjet palëve**

7.1 Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore në adresat e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.

7.2 Në rast se personat dhe/ose adresat e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palen tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën.

### **NENI 8 Ndryshimet e kontratës**

8.1 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim dhe në nënshkruhet nga të gjitha palët në këtë Kontratë.

### **NENI 9 Interpretimi i kontratës**

9.1 Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërsia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

9.2 Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj kontrate. Kushti i pavlefshëm në këtë rast do të zëvëndësohet me një të vlefshëm, i cili do t'i përkøjë sa më shumë të jetë i mundur qëllimeve të palëve.

9.3 Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **NENI 10 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiken t'i zgjidhin me mirëkuptim.

10.2 Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 11**  
**Të tjera**

11.1 Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:

12.1.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;

12.1.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shitësit;

12.1.3. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë;

12.1.4. Vendim datë 14/12/2023 i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "Apsus" shpk.

11.2 Kjo kontratë është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese.

11.3 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga falët.

**PALËT**

**SHITËSI**


Shoqëria "Anio Oil&Gas"sha

Alban Peza



**BLERËSI**

Ela Puka



Shoqëria "Apsus"shpk  
Nuis: M21730029U  
Selia: Tiranë, Rr.“Brigada 8”, Ndërtesa Nr.4,  
Kati 7, Ap.Nr.21&Nr.22

VENDIM DATË 14/12/2023  
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE  
TË SHOQËRISË“APSUS”SHPK

Sot, më datë 14/12/2023, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Apsus”shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nuis M21730029U. Në këtë mbledhje janë të pranishëm personalisht të tre ortakët:

- Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha, e cila zotëron 60% të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, përfaqësuar personalisht nga Aksionari i saj i vetëm Z.Alban Peza, i cili zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë “Anio Oil&Gas”sha;
- Z.Alban Peza, i cili zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk;
- Z.Andon Daka, i cili zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk.

Në bazë të nenit 86 dhe 87 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, mbledhja konsiderohet e rregullt.

Rendi i ditës është si më poshtë:

1. Miratimi i shitjes nga shoqëria “Anio Oil&Gas”sha të 20%(njëzetë përqind) të kapitalit që shoqëria “Anio Oil&Gas”sha zotëron tek shoqëria “Apsus”shpk me NUIS M21730029U, në favor të Znj.Ela Puka, sipas Kontratës së shitjes dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do lidhet ndërmjet palëve për këtë qëllim;
2. Të ndryshme.

Duke qenë se ortakët e konsiderojnë të shteruar të drejtën e parablerjes, përsa më sipër, ortakët unanimisht, pasi shqyrtuan rendin e ditës,

**VENDOSËN:**

1. Të miratojnë shitjen nga shoqëria “Anio Oil&Gas”sna të 20%(njëzetë përqind) të kapitalit që shoqëria “Anio Oil&Gas”sha zotëron tek shoqëria “Apsus”shpk me NUIS M21730029U, në favor të Znj.Ela Puka sipas Kontratës së shitjes dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në kontratën që do lidhet ndërmjet palëve për këtë qëllim;
2. Përfundimisht, pas nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes, struktura e kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk do të jetë si më poshtë vijon:
  - i. Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 40%(dyzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 40,000(dyzetëmijë) Lekë;

1



- ii. Z.Alban Peza do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
- iii. Z.Andon Daka, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë;
- iv. Znj.Ela Puka, do të zotërojë pas nënshkrimit të kësaj kontrate një kuotë, e cila do të përfaqësojë 20%(njëzetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “Apsus”shpk, me vlerë 20,000(njëzetëmijë) Lekë.

#### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha  
Përfaqësuar nga Aksionari i vetëm  
Alban Peza

